



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:265430

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06370860

C.nr.4511/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.B. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komuna e Arsimit, Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të kontestit anulim i vendimeve, kthimi në vendin e punës, kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës dhe dëmit jo material, vlera e kontestit 5,000.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prani të paditësit, të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarës së të paditurës, më datë 16.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit L.B. nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar që “të anulohet vendimi i Komisionit Disiplinor pranë Komunës së Prizrenit nr. 01-116/01-0154818/23 i datës 01.11.2023 dhe vendimi i Komisionit të Ankesave pranë Komunës së Prizrenit nr. 01-030-160966/23 i datës 24.11.2023, të kthehet paditësi në vendin e punës si mësimdhënës i lëndës Fizike pranë SHFMU “Mustafa Baku” në Prizren, detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t’i kompensoj dëmin në pagë nga ndërprerja e marrëdhënies së punës, detyrohet e paditura që paditësit t’ia vazhdoj kontratën e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës dhe detyrohet e paditura në kompensimin e shpenzimeve procedurale”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi L.B. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.Sh. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komuna e Arsimit, Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të kontestit anulim i vendimeve, kthimi në vendin e punës, kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës dhe dëmit jo material, vlera e kontestit 5,000.00 euro.

Në padi ka theksuar se e paditura me dy vendime, në një periudhë pa kaluar ende 6 muaj, ka shkelur procedurat dhe dispozitat ligjore ndaj paditësit. E paditura me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punë ndaj paditësit, ka bërë diskriminim ndaj të njëjtit. Komisioni Disiplinor i të paditurës me ndërprerjen arbitrare të marrëdhënies së punës ndaj paditësit, bie ndesh me nenin 5 par. 1, 4 dhe 5, nenin 70 par. 2, 3 dhe 4, nenin 71, nenin 72, nenin 78, nenin 79 e lidhur me nenin 80 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212. Kështu, duke cenuar dispozitat ligjore të theksuara

më lartë, e paditura ka bërë diskriminim dhe mohim të punësimit ndaj paditësit si arsimtar me përvojë shumë vjeçare. Po ashtu, me vendimin e të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit, janë cenuar edhe të drejtat e paditësit nga marrëdhënia e punës të garantuar me konventa dhe instrumente ndërkombëtare. Komisioni Disiplinor i të paditurës nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen ose e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike kur paditësit ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës. Komisioni Disiplinor ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit pa paralajmërim, pa asnjë arsytim ligjor dhe një vendim i tillë është në kundërshtim me nenin 40 të Rregullores për Marrëdhënie Pune nr. 01/2017 të datës 12.01.2017. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura në kompensimin e shpenzimeve të procedurës.

Me parashtrësën e datës 01.02.2024, i autorizuari i paditësit ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë në aspektin objektiv. Gjykata me aktvendimin e marrë në procesverbalin e seancës përgatitore të datës 30.04.2024, ka lejuar precizimin e kërkesëpadiisë.

Në përgjigjen në padi, e paditura përmes të të autorizuarës së saj ka deklaruar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Padia e paditësit është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me ligj, në përputhje me nenin 393 lidhur me nenin 391 të LPK-së. Andaj ka propozuar që padia e paditësit të hedhet poshtë si e palejueshme.

Gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se gjatë procedurës së provave është vërtetuar se Komisioni Disiplinor i të paditurës pa asnjë bazë të vetme ligjore dhe provë, paditësit ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës. Po ashtu, Komisioni i Ankesave ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme, ku ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi Vendimin e Komisionit Disiplinor, pa anuluar vendimin nr. 1507 të datës 15.08.2023 dhe kështu ky komision ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren nr/11/2020 për disiplinën dhe ankesat e zyrtarëve publik. Po ashtu, Komisioni Disiplinor dhe i Ankesave, ka vepruar në kundërshtim me nenin 47 lidhur me nenin 74 të Ligjit për zyrtarët publik nr. 06/L-114 të datës 02.02.2019, pasi që pa arsye kanë marrë veprime diskredituese ndaj paditësit, pasi që inicimi i procedurës disiplinore nuk bëhet nga Drejtori i Shkollës dhe psikologjia. Kështu, e paditura pa asnjë arsye dhe provë ka bërë ndërprerjen e marrëdhënies në shërbim publik të paditësit, duke e vendosur në situatë diskriminuese. Paditësi duke ushtruar punën e tij në mënyrë profesionale dhe duke respektuar kodin e etikës së një mësimdhënësi ku ka kaluar gjenerata të ndryshme, me asnjë procedurë të vetme i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga e paditura, me supozimet e drejtorit të shkollës dhe psikologes. Paditësit i janë shkëlur të drejtat e punësimit të garantuara me Kushtetutë, ligj, akte nënligjore, por edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor, përkatësisht nga vërejtjet ndaj nxënësve të marrë nga ditari i shkollës dhe vërejtjes ndaj nxënëses D.H. është ndikuar që Drejtori i Shkollës dhe psikologjia të iniciojnë procedurën për largimin e paditësit nga puna. Po ashtu, nga dëshmia e dëshmitares është vërtetuar se largimi nga puna i paditësit ka qenë i paligjshëm dhe i padrejtë, duke theksuar se nuk ka votuar që paditësi të largohet nga puna, pasi që nuk është bindur që paditësi duhet të largohet nga puna. Andaj, ka propozuar që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar, paditësi të kthehet në vendin e punës dhe të detyrohet e paditura që t'ia kompensoj dëmin material në emër të pagave dhe dëmin jo material. Po ashtu, ka kërkuar që detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,081.60 euro, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

E autorizuar e të paditurës, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi si në përgjigje në padi dhe në seancat paraprake, në bazë të fakteve dhe

provave të administruara në shqyrtimin kryesor, paditësi nuk ka arritur të vërtetoj faktin se me vendimet e nxjerra nga Komuna e Prizrenit i është shkëllur e drejta e tij nga marrëdhëniet e punës, përkatësisht këto pretendime të paraqitura në padi paditësi nuk ka arritur t'i argumentoj rrjedhimisht nuk ka prezantuar fakte bindëse lidhur me pretendimet e tij. Me vendimin e komisionit disiplinor të datës 01.11.2023, paditësit i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerja e marrëdhënies së punës si mësimdhënës i lëndës së fizikës, i cili vendim është marr pas shqyrtimit paraprak të dosjes së lëndës së paditësit me të cilat ka disponuar ky komision siç janë dëshmitë nga drejtori i shkollës, psikologes, kujdestarëve të klasave e të cilat dëshmi përputhen me deklaratat e nxënësve të bëra nga psikologja e shkollës e të cilat veprime të paditësit janë në kundërshtim me ligjin para universitar neni 4 si dhe rregulloret tjera dhe ligjet tjera aktuale në fuqi. Këtë vendim e arsyeton si të drejtë dhe të ligjshëm vendimi i komisionit të ankesave me çka i është refuzuar edhe ankesa e paditësit ndaj vendimit të komisionit disiplinor. Meqenëse nga pretendimet e paditësit ka pasur pretendime lidhur me vlefshmërinë e vendimit të komisionit disiplinor, konsiderojmë se ky vendim bazuar edhe në përgjigjen e dëshmitares e cila ka qenë anëtare e komisionit përkatësisht vendosja bëhet me shumicë votash, pra është legjitim nëse do të nënshkruhen mbi tre anëtarë të komisionit. Në bazë të lartcekurave si dhe provave që janë administruar në shqyrtimin kryesor, e paditura konsideron se padia si e tillë është e pabazuar dhe kërkojmë që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar.

Gjendja faktike e vërtetuar dhe provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: dëgjimin e dëshmitares H.H. kontratën e punës numër protokollit 780/2020 e datës 09.12.2020, vendimin e Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 1507 i datës 15.08.2023, vendimin e Komisionit të Ankesave të të paditurës numër 1515/2023 i datës 25.08.2023, ankesën numër 1515 e datës 18.08.2023, vendimin e Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 06-116/01-73690/23 i datës 26.05.2023, vendimin e Komisionit të Ankesave të të paditurës numër 01-116/01-08004623 i datës 09.06.2023, ankesën numër 165 e datës 04.05.2023, vendimin e Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 01-116/01-0154818 i datës 01.11.2023, vendimin e Komisionit të Ankesave të të paditurës numër 01-030-160966/23 i datës 24.11.2023, procesverbalin e Komisionit të Ankesave të të paditurës i datës 18.07.2023 dhe 28.07.2023, ankesën e datës 11.11.2023, parashtruar nga i autorizuari i paditësit ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 01.11.2023, vërejtjet ndaj nxënësve të marrë nga ditari i shkollës "Emin Duraku"-vërejtjet ndaj nxënëses D.H. raportin mjekësor të kardiologjisë lëshuar nga Dr. A.P. më datë 26.05.2023, raportin nga konsulta e lëshuar nga Dr. I.P. më datë 02.05.2024, komunikimin në rrjetin social "Viber" ndërmjet paditësit dhe O.Q. dhe Z.Q. vendimin e Komisionit të Ankesave të të paditurës numër 01-11-125513 i datës 27.09.2023, procesverbali i Komisionit të Ankesave të të paditurës i datës 25.09.2023 dhe 27.09.2023, ankesën numër 125513 e datës 30.08.2023, parashtruar nga drejtori i shkollës "Emin Duraku" në Prizren, procesverbalin e Komisionit të Ankesave të të paditurës i datës 24.11.2023, kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj paditësit numër 56889 e datës 24.04.2023, raportet për sjelljen jo të mirë të paditësit të datës 14.03.2022, 24.10.2022 dhe 24.11.2022 përgatitur nga psikologja e shkollës "Emin Duraku", raportin nga takimi i Këshillit Drejtues të shkollës "Emin Duraku" numër 227/2023 i datës 19.06.2023, vendimin numër 689/2022 e datës 22.12.2022 dhe vendimin numër 141/2023 e datës 26.04.2023, vërejtjet- ankesat e bëra nga personat anonim ndaj paditësit të datës 24.11.2022.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

- kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Dëshmitarja H.H. gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se nga viti 2021 deri në vitin 2023, pra dy vite ka qenë anëtare e Komisionit Disiplinor pranë Komunës së Prizrenit, nga radhët e SBASHK-ut, Komision i cili sa ka njohuri është në kuadër të Komunës së Prizrenit. Si anëtare e Komisionit Disiplinor, kanë shqyrtuar lëndën e paditësit, ku kanë pasur Drejtorin e Shkollës, Psikologjen e Shkollës dhe dy kujdestarët e klasave për nxënësit në fjalë që janë ankuar e paditësi po ashtu. Lidhur me deklaratat e nxënësve në Komision Disiplinor, nuk janë paraqitur në emër të tyre, janë disa deklarata apo ankesa që nuk kemi pasur mundësi t'i lexojmë shkrimet e tyre dhe si mësimdhënëse, nuk jam bindur që të nënshkruaj vendimin për të larguar një mësimdhënëse nga puna e tij. Pra vendimin për largim nga puna të paditësit nuk e ka nënshkruar për faktin se nuk e ka bindur intervista e psikologes dhe paditësin e njeh që një kohë të gjatë dhe nuk ka pasur fakte apo provë me të cilën do të argumentohet dhuna e paditësit. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision Disiplinor, aknë pasur shumë ankesa anonime dhe të njëjtat nuk kanë pasur shumë rëndësi. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit janë marrë parasysh edhe ankesat e dy nxënësve: Sh.G. dhe A.Ç. Vendimin e Komisionit Disiplinor nuk e ka nënshkruar për faktin se ka nuk qenë e bindur se është i drejtë vendimi për largim të paditësit nga shërbimi publik, pra ka kërkuar që ndaj paditësit të shqiptohet një masë më e butë, qoftë suspendim nga puna apo transfer në një shkollë tjetër përkohësisht. Vendimmarrja në Komision Disiplinor bëhet me shumicë votash, pra mbi tre anëtarë mund të marrin vendim për një çështje të caktuar, në rastin konkret pro këtij vendimi kanë qenë katër anëtarë, ndërsa ai ka qenë kundër, që i bie se vendimi ka mundur të merret me ato vota të dhëna nga anëtarët, por të gjithë anëtarët janë zyrtarë të Komunës së Prizrenit dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe asnjëri nuk është punëtor i arsimit dhe nuk e dinë gjendjen dhe situatën në shkolla. Sa i përket Komisionit Disiplinor të të paditurës, nuk e di çfarë përbërje duhet të ketë.

Nga leximi i kontratës së punës numër protokollit 780/2020 e datës 09.12.2020, vërtetohet se paditësi ka qenë i punësuar si mësimdhënësi i lëndës së fizikës në ShFMU "Emin Duraku", Prizren, nga data 09.12.2020.

Nga leximi i vendimit të Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 1507 i datës 15.08.2023, është vërtetuar se paditësi është larguar përkohësisht nga puna për gjashtë (6) muaj dhe gjatë kësaj periudhe i ka takuar e drejta e kompensimit në pagë në lartësi prej 50%.

Nga leximi i vendimit të Komisionit të Ankesave të të paditurës numër 1515/2023 i datës 25.08.2023, u vërtetua se është refuzuar e pabazuar ankesa nr. 1515 e datës 18.08.2023, parashtruar nga paditësi L.B. ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 1507 i datës 15.08.2023.

Nga leximi i ankesës numër 1515 e datës 18.08.2023, është vërtetuar se paditësi L.B. ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 1507 i datës 15.08.2023, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

Nga leximi i vendimit të Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 06-116/01-73690/23 i datës 26.05.2023, vërtetohet se paditësi është pezulluar nga vendi i punës si mësimdhënësi i

lëndës fizike në ShFMU “Emin Duraku”, Prizren, të njëjtit nuk i është cenuar e drejta e pagës, ndërsa i është ndaluar ushtrimi i detyrës dhe prezenca në objektin shkollor.

Nga leximi i vendimit të Komisionit të Ankesave të të paditurës numër 01-116/01-08004623 i datës 09.06.2023, u vërtetua se është refuzuar e pabazuar ankesa e datës 01.06.2023, parashtruar nga paditësi L.B. ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 06-116/01-73690/23 i datës 26.05.2023.

Nga leximi i ankesës numër 165 e datës 04.05.2023, vërtetohet se paditësi L.B. ka parashtruar ankesë ndaj vendimit numër 141/2023 i datës 26.04.2023, me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore vërejtje me shkrim, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

Nga leximi i vendimit të Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 01-116/01-0154818 i datës 01.11.2023, u vërtetua se paditësi është larguar nga shërbimi publik- mësimdhënës i lëndës fizike në ShFMU “Emin Duraku”, Prizren.

Nga leximi i vendimit të Komisionit të Ankesave të të paditurës numër 01-030-160966/23 i datës 24.11.2023, është vërtetuar se është refuzuar e pabazuar ankesa nr. 01-030-160966/23 e datës 15.11.2023, parashtruar nga paditësi L.B. ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 01-116/01-0154818 i datës 01.11.2023.

Nga leximi i procesverbalit të Komisionit Disiplinor të të paditurës i datës 18.07.2023 dhe 28.07.2023, është vërtetuar se në procesverbalin e datës 18.07.2023, Komisioni Disiplinor i të paditurës ka bërë dëgjimin e paditësit lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij, i njëjti është ballafaquar me ankesat që kanë bërë nxënësit e ShFMU “Emin Duraku ndaj paditësit, raportet e përgatitura nga psikologjia për sjellje jo të mirë të paditësit dhe raportet tjera dhe se në disa raste, paditësi pranon se ka përdorur dhunë fizike, dhunë psikike dhe fjalë fyese e ofenduese si mësimdhënës ndaj nxënësve të ShFMU “Emin Duraku”, Prizren. Po ashtu, në procesverbalin e datës 28.07.2023, vërtetohet se është vazhduar mbledhja e Komisionit Disiplinor të të paditurës, në të cilën paditësi është ballafaquar me ankesa tjera të nxënësve të ShFMU “Emin Duraku”, Prizren.

Nga leximi i ankesës së datës 11.11.2023, parashtruar nga i autorizuari i paditësit ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 01.11.2023, vërtetohet se i autorizuari i paditësit ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 01-116/01-0154818 i datës 01.11.2023, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurave ligjore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të të drejtës materiale dhe shkeljeve të afateve ligjore.

Nga leximi i vërejtjeve ndaj nxënësve të marrë nga ditari i shkollës “Emin Duraku”- vërejtjet ndaj nxënëses D.H. u vërtetua se ndaj nxënëses D.H. janë shqiptuar tre vërejtje nga ana e mësimdhënësve dhe të njëjtës i është thyer nota e sjelljes në 3 (mirë).

Nga leximi i raportit mjekësor të kardiologjisë lëshuar nga Dr. A.P. më datë 26.05.2023, vërtetohet se paditësi ka bërë vizitë mjekësore specialistike për shkak të dhimbjes së kokës dhe marramendjes, ndërsa rezultati i vizitës mjekësore rezulton se frymëmarrja normale, tonet e zemrës të qarta dhe ndaj të njëjtit është rekomanduar terapia mjekësore dhe analizave mjekësore specialistike.

Nga leximi i raportit nga konsulta e lëshuar nga Dr. I.P. më datë 02.05.2024, është vërtetuar se paditësi ka bërë vizitë mjekësore specialistike për shkak të çrregullimit stresogjen dhe ndaj të njëjtit është rekomanduar terapia adekuate mjekësore.

Nga leximi i komunikimit në rrjetin social “Viber” ndërmjet paditësit dhe O.Q. dhe Z.Q. vërtetohet se paditësi ka biseduar me personin O.Q. dhe Z.Q. lidhur me ankesat e nxënësve ndaj paditësit.

Nga leximi i vendimit të Komisionit të Ankesave të të paditurës numër 01-11-125513 i datës 27.09.2023, u vërtetua se është aprovuar e bazuar ankesa e drejtorit të shkollës “Emin Duraku” ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 1507 i datës 15.08.2023 dhe është obliguar Komisioni Disiplinor i të paditurës që edhe një herë të shqyrtoj lëndën ndaj paditësit.

Nga leximi i procesverbalit të Komisionit të Ankesave të të paditurës i datës 25.09.2023 dhe 27.09.2023, është vërtetuar se në seancën e datës 25.09.2023, pranë Komisionit të Ankesave të të paditurës është dëgjuar psikologjia e ShFMU “Emin Duraku”, ku ka sqaruar të gjitha rastet dhe ankesat e nxënësve, ngacmimet seksuale dhe veprimet tjera të paditësit ndaj nxënësve të shkollës. Ndërsa, në seancën e datës 27.09.2023, Komisioni i Ankesave i të paditurës ka konstatuar që me shumicë votash është marrë vendim që Komisioni Disiplinor i të paditurës ta shqyrtoj edhe një herë lëndën sipas vendimit numër 1507 i datës 15.08.2023.

Nga leximi i ankesës numër 125513 e datës 30.08.2023, parashtruar nga drejtori i shkollës “Emin Duraku” në Prizren, vërtetohet se drejtori i shkollës “Emin Duraku”, Prizren, ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 1507 i datës 15.08.2023, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore të Ligjit Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Nga leximi i procesverbalit të Komisionit të Ankesave të të paditurës i datës 24.11.2023, u vërtetua se Komisioni i Ankesave i të paditurës ka vendosur të lë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor të të paditurës, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin publik, ndaj paditësit.

Nga leximi i kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj paditësit numër 56889 e datës 24.04.2023, vërtetohet se drejtori i shkollës “Emin Duraku”, Prizren, ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj paditësit, për shkak sjelljeve jo të mira dhe shkeljeve të bëra nga i njëjti.

Nga leximi i raporteve për sjelljen jo të mirë të paditësit të datës 14.03.2022, 24.10.2022 dhe 24.11.2022 përgatitur nga psikologjia e shkollës “Emin Duraku”, është vërtetuar se psikologjia e shkollës “Emin Duraku”, ka pasqyruar ankesat e nxënësve të kësaj shkolle, për shkak se paditësi nuk mund të menaxhonte orën mësimore, ngacmimeve seksuale që paditësi bënte ndaj nxënësve, dhunës psikologjike dhe fizike të paditësit ndaj nxënësve.

Nga leximi i raportit nga takimi i Këshillit Drejtues të shkollës “Emin Duraku” numër 227/2023 i datës 19.06.2023, u vërtetua se Këshilli Drejtues i shkollës “Emin Duraku” është njoftuar me vendimin e Komisionit Disiplinor për pezullimin e paditësit nga puna deri në marrjen e vendimit përfundimtar dhe ky Këshill ka mirëpritur vendimin e Komisionit Disiplinor.

Nga leximi i vendimit numër 689/2022 e datës 22.12.2022 dhe vendimit numër 141/2023 e datës 26.04.2023, është vërtetuar se ndaj paditësit është shqiptuar masa disiplinore vërejtje me

gojë dhe vërejtje me shkrim, për shkak të shkeljeve disiplinore, masa të cilat janë shqiptuar nga Drejtoria e shkollës “Emin Duraku”, Prizren.

Nga leximi i vërejtjeve- ankesave të bëra nga personat anonim ndaj paditësit të datës 24.11.2022, vërtetohet se ndaj paditësit janë bërë disa ankesa në mënyrë anonime, për shkak të sjelljeve jo etike të të njëjtit ndaj nxënësve, ngacmimeve fizike e seksuale të tij, dhunës psikologjike e fizike ndaj nxënësve.

Baza ligjore

Sipas nenit 64 par. 1 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë (LZP) përcaktohet që “përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës. Ndërsa, në paragrafin 2 të nenit të lartcekur në mënyrë shprehimore parashihet që “kjo pjesë e Ligjit përcakton rregullat për procedurën e konkurrimit, vlerësimin e punës, disiplinën e nëpunësit të Shërbimit Publik, si dhe procedurën e ndërprerjes të marrëdhënies së punës në rastet e vlerësimit “jo kënaqshëm” dhe shkeljeve disiplinore”. Pastaj, në nenin 72 par. 1 të LZP-së theksohet se “nëpunësi i shërbimit publik është përgjegjës për keqsjelljen profesionale dhe shkeljen e detyrimeve profesionale në pajtim me ligjin”. Në vazhdim, në paragrafin 3 dhe 4 të nenit 72 të LZP-së thuhet që “përveç kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë, në çdo administratë të shërbimeve publike krijohet një komision disiplinor. Komisioni disiplinor përbëhet nga: 1. një përfaqësues i NJBNJ- së; 2. dy përfaqësues të organit emërtues; 3. një jurist i organit emërtues; 4. një përfaqësues i sindikatës apo i përfaqësuesve të nëpunësve të shërbimit publik përkatës.

Më tutje, në nenin 46 par. 1 të LZP-së është paraparë që “shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. Në vijim, në paragrafin 2 dhe 3 të nenit të lartcekur thuhet se “shkeljet disiplinore ndahen në: 1. shkelje të rënda; 2. shkelje të lehta. Shkelje të rënda konsiderohen: 1. mospërbushja e detyrave të punës; 2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë”.

Pastaj, në nenin 47 par. 1 të LZP-së parashihet se “masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1. vërejtje; 2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga 2 deri 5 vjet; 4. largimi nga Shërbimi Civil”. Sipas nenit 48 par. 2 të LZP-së theksohet që “mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”.

Në vazhdim, me nenin 48 par. 3 të LPK-së përcaktohet që “masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1 pika 2 deri 4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”. Ndërsa, në nenin 48 par. 4 nën par. 1 të LZP-së ceket se “komisioni disiplinor fillon procedurën me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil”.

Në nenin 72 par. 2 të LZP-së parashihet që “dispozitat e neneve 45 deri 48 dhe 50, 51 të këtij ligji zbatohen edhe për disiplinën e nëpunësit të Shërbimit Publik”.

Në anën tjetër, në nenin 4 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës theksohet që “të gjithë personat e punësuar në institucione arsimore, të themeluara sipas këtij ligji, do të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm që të sigurojnë se nxënësit dhe punonjësit nuk lëndohen apo u ekspozohen fjalëve dhe veprimeve fyese”. Ndërsa, në paragrafin 2 të nenit të lartcekur thuhet se “ndalohet ndëshkimi fizik apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit nënçmues në të gjitha institucionet arsimore dhe aftësuese, qofshin ato publike ose private”.

Në fund, me Rregulloren nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, në mënyrë të detajuar parashihet procedura disiplinore, shkeljet disiplinore dhe masat disiplinore. Kështu, në nenin 4 rregullohet procedura disiplinore ndaj zyrtarëve publik, në nenin 5 parashihen llojet e shkeljeve disiplinore, neni 8 përcakton kompetencën e organeve për shqiptimin e masave disiplinore, ndërsa në nenin 11, 12 dhe 13 të Rregullores përcaktohen kompetencat e Komisionit Disiplinor, seancat e Komisionit Disiplinor dhe shqiptimi i masave disiplinore.

Ndërsa, me nenin 7 par. 1 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) është paraparë se “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Me nenin 2 par. 2 të LPK-së është paraparë se “gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në këtë drejtim, gjykata pas administrimit të provave gjatë shqyrtimit kryesor, të propozuara nga pala paditëse dhe ajo e paditur, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues fakti se paditësi L.B. ka qenë në marrëdhënie pune pranë të paditurës, përkatësisht mësimdhënës i lëndës së fizikës në ShFMU “Emin Duraku”, Prizren. Po ashtu, kontestuese nuk ishte që e paditura, respektivisht Komisioni Disiplinor i të paditurës, paditësit i ka shqiptuar masën disiplinore largim nga shërbimi publik dhe se Komisioni i Ankesave i të paditurës ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor të të paditurës.

Kontestuese në këtë çështje juridike ishte nëse masa disiplinore e shqiptuar ndaj paditësit nga e paditura, është e bazuar dhe e ligjshme, përkatësisht nëse është respektuar procedura ligjore me rastin e shqiptimit të kësaj mase disiplinore.

Së këndejmi, gjykata vlerëson se vendimi i Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 01-116/01-0154818 i datës 01.11.2023, nuk është i kundërligjshëm dhe se nxjerrja e një vendimi

të tillë është bërë në përputhje me dispozitat ligjore të akteve juridike të theksuara më lartë. Kështu, me nenin 47 par. 1 të LZP-së shprehimisht është rregulluar mundësia që për shkeljen e detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, nëpunësit publik do t'i shqiptohet edhe largimi nga shërbimi publik. Ndërsa, me nenin 8 par. 3 të Rregullores nr. 11/2020 përcaktohet qartë se masa disiplinore largimi nga shërbimi publik shqiptohet për shkak të shkeljeve të rënda disiplinore, të përcaktuara në nenin 46 par. 3 të LZP-së. Pastaj, në nenin 48 par. 3 të LZP-së dhe nenin 8 par. 3 dhe nenin 11 par. 1 të Rregullores nr. 11/2020, në mënyrë konkrete përcaktohet kompetenca e Komisionit Disiplinor për përcaktimin dhe shqiptimin e masës disiplinore, në këtë rast edhe masës largim nga shërbimi publik. Në vazhdim, në nenin 48 par. 4 të LZP-së, shprehimisht përcaktohet se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit publik ka tagër që të filloj procedurën disiplinore.

Kështu, në nenin 46 par. 3 të LZP-së, në mënyrë taksative janë përcaktuar dhe listuar se cilat veprime të nëpunësve publik përbëjnë shkelje të rënda të detyrave të punës. Në këtë rast, Komisioni Disiplinor në përputhje me kompetencat e përcaktuara me LZP dhe Rregulloren nr. 11/2020, procedurën disiplinore e ka filluar sipas kërkesës së drejtorit të ShFMU “Emin Duraku”, Prizren (mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i paditësit). Gjithashtu, Komisioni Disiplinor ka zbatuar procedurën sipas dispozitave ligjore të LZP-së dhe Rregullores nr. 11/2020, duke garantuar të drejtën e paditësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Kështu, nga procesverbali i Komisionit Disiplinor të të paditurës i datës 18.07.2023 dhe 28.07.2023, rezulton se i padituri është dëgjuar dhe ballafaquar lidhur me faktet dhe provat e paraqitura kundër tij me rastin e inicimit të procedurës disiplinore dhe të njëjtit i është dhënë mundësia e paraqitjes së fakteve dhe provave në atë çështje, ku i njëjti ka deklaruar se nuk ka asnjë vërejtje në shqyrtimin dhe deklarimin e bërë gjatë Komisionit Disiplinor. Andaj, çështja e përcaktimit dhe shqiptimit të masës përkatëse disiplinore, e cila i është shqiptuar paditësit me vendimin e Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 01-116/01-0154818 i datës 01.11.2023, është në përputhje me dispozitat ligjore të LZP-së, LAPRK-së dhe Rregullores nr. 11/2020 dhe procedura e ndjekur nga Komisioni Disiplinor i të paditurës është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të lartcekura.

Gjithashtu, përbërja e Komisionit Disiplinor të të paditurës është në përputhje me dispozitat ligjore, respektivisht nenin 72 par. 4 të LZP-së. Kështu, nga procesverbali i Komisionit Disiplinor të të paditurës i datës 18.07.2023 dhe 28.07.2023 dhe vendimi i Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 01-116/01-0154818 i datës 01.11.2023, rezulton se Komisioni është formuar nga pesë anëtarë, A.A.- kryesuese (zyrtare ligjore pranë të paditurës), I.G.- anëtar (zyrtar nga Zyra e Burimeve Njerëzore), F.K. dhe H.G.- anëtarë (përfaqësues nga e paditura- Drejtoria Komunale e Arsimit) dhe H.H.- anëtare (përfaqësuese nga SBAShK-u). Në këtë drejtim, në nenin 72 par. 4 të LZP-së përcaktohet që “Komisioni disiplinor përbëhet nga: 1. një përfaqësues i NJBNJ- së; 2. dy përfaqësues të organit emërtues; 3. një jurist i organit emërtues; 4. një përfaqësues i sindikatës apo i përfaqësuesve të nëpunësve të shërbimit publik përkatës.

Gjykata vlerëson se në kontestet e punës që zhvillohen në gjykatë përkitazi me anulimin e vendimit lidhur masën disiplinore, ajo vlerëson ligjshmërinë e aktit juridik me anë të cilit nëpunësit publik (në këtë rast paditësit) i është shqiptuar masa përkatëse disiplinore. Vlerësimi i tillë i ligjshmërisë së aktit juridik, në radhë të parë nënkupton nëse është zhvilluar apo jo procedura administrative sipas rregullave ligjore, pra në këto raste gjykata vlerëson vetëm nëse

është zhvilluar procedura e paraparë me ligj dhe me aktet normative. Pra, në rastin konkret gjykata më lartë ka arsyetuar se Komisioni Disiplinor i të paditurës ishte në përbërje të rregullt siç parashihet me Ligjin nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik, paditësit i është dhënë mundësia të dëgjohet e deklarohet lidhur me procedurën disiplinore, Komisioni Disiplinor i të paditurës ishte me kompetencë për vendosjen lidhur me masën disiplinore dhe masa disiplinore e shqiptuar ndaj paditësit ishte e paraparë dhe përcaktuar me LZP-në dhe Rregullores nr. 11/2020. Gjykata në raste të tilla (siç është theksuar edhe më lartë), nuk ka autorizim ligjor të vërtetoj nëse paditësi ka bërë shkelje të rëndë apo jo të detyrave të punës. Pra, komisione përkatëse profesionale (në rastin konkret Komisioni Disiplinor) janë ato që vlerësojnë se nëse një sjellje apo veprim i nëpunësit publik përbën shkelje disiplinore. Në rastin konkret, Komisioni Disiplinor i të paditurës kishte vendosur që paditësi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, dhe të njëjtit i është shqiptuar masa disiplinore largim nga shërbimi publik.

Gjithashtu, pasi që gjykata erdhi në përfundim se vendimi i Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 01-116/01-0154818 i datës 01.11.2023 është i ligjshëm dhe konform dispozitave ligjore, gjykata gjeti se edhe vendimi i Komisionit të Ankesave të të paditurës numër 01-030-160966/23 i datës 24.11.2023 nuk është i kundërligjshëm. Kjo pasi që ky vendim është marrë nga organi i cili ka kompetencë dhe autorizim për të nxjerrë një vendim të tillë, në përputhje me dispozitat ligjore dhe duke respektuar procedurën përkatëse ligjore.

Nga të gjitha faktet dhe arsyet e theksuara më lartë, gjykata ka vendosur që të refuzoj propozimin e palës paditëse për nxjerrjen e provës përmes ekspertizës nga lëmi financiar dhe psikiatrik. Kështu, përmes nxjerrjes së kësaj prove do të mund të provohej në mënyrë specifike dhe konkrete lartësia e të ardhurave nga marrëdhënia e punës, përkatësisht dhimbjet shpirtërore, frika dhe ankthi eventual i përjetuar nga ana e paditësit. Mirëpo, duke marrë për bazë se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit nuk ishte e bazuar dhe pa mbështetje juridike, gjykata erdhi në përfundim se vendosja për nxjerrjen e provës përmes ekspertizës nga lëmi financiar, nuk do t'i kontribuonte në asnjë mënyrë kësaj çështje juridike. Po ashtu, dëmi jomaterial i pretenduar nga pala paditësi duhet të rrjedh nga veprimi i kundërligjshëm, ndërsa gjykata gjeti se vendimet e nxjerra nga pala e paditur ishin të ligjshëm dhe në përputhje me dispozitat ligjore, dhe në këto rrethana gjykata vendosi që të mos nxirret prova përmes ekspertizës nga lëmi i psikiatrisë. Mbi këtë bazë, duke marrë parasysh faktin se gjykata gjatë gjithë procedurës kontestimore kujdeset sipas detyrës zyrtare sa i përket parimeve bazike mbi të cilat funksionon procedura kontestimore, konkretisht parimi i efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës, gjykata nuk ka caktuar nxjerrjen e provës përmes ekspertizës nga lëmi financiar dhe i psikiatrisë.

Gjykata vlerësoi pretendimin e palës paditëse se e paditura nuk ka respektuar afatet dhe dispozitat ligjore, pasi që pa kaluar 6 muaj, është marrë vendimi i Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 1507 i datës 15.08.2023, me të cilin paditësi është larguar përkohësisht nga puna për gjashtë (6) muaj dhe pastaj është marrë vendimi i Komisionit Disiplinor të të paditurës numër 01-116/01-0154818 i datës 01.11.2023, me të cilin paditësi është larguar nga shërbimi publik, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar dhe pa mbështetje juridike. Kështu, vendimi numër 1507 i datës 15.08.2023 është nxjerrë nga ana e Komisionit Disiplinor, mirëpo pas ankesës së parashtruar nga drejtori i ShFMU “Emin Duraku”, Prizren (si autoritet kompetent për inicimin e procedurës disiplinore), Komisioni i Ankesave i të paditurës ka nxjerrë vendimin numër 01-11-125513 i datës 27.09.2023, me të cilin është obliguar Komisioni Disiplinor i të paditurës që edhe një herë të shqyrtoj lëndën ndaj paditësit. Pastaj, pasi që Komisioni Disiplinor ka zhvilluar dhe shqyrtuar procedurën disiplinore ndaj paditësit,

ka nxjerrë vendimin numër 01-116/01-0154818 i datës 01.11.2023, me të cilin paditësi është larguar nga shërbimi publik e të cilin vendim gjykata e vlerësoi si të ligjshëm, për shkaqet dhe arsyet e theksuara më lartë.

Po ashtu, gjykata mori parasysh pretendimin e të autorizuarit të paditësit që drejtori i shkollës “Emin Duraku” nuk ka pasur të drejtë të iniciojë procedurën disiplinore ndaj paditësit, por erdhi në përfundim që një pretendim i tillë është tërësisht i pabazuar dhe pa justifikim juridik. Në këtë drejtim, sipas nenit 48 par. 4 nën par. 1 të LZP-së përcaktohet që Komisioni Disiplinor e fillon procedurën disiplinore me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit publik, në këtë rast drejtorit të ShFMU “Emin Duraku”, Prizren.

Andaj, duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet e pabazuar, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera të administruara në shqyrtim kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe meritore të kësaj çështje juridike kontestimore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata vendosi si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 450 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në përputhje me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.4511/2023, datë 16.10.2024

Gjyqtari
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.